

Sadat AGUSHI

VEÇORITË FONETIKO-MORFOLOGJIKE NË TË FOLMEN E MIRATOCIT TË PRESHEVËS

Abstrakti: Të folmet e shqipes janë të pasura me dukuri fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikore dhe këto më shumë janë të shfaqura në dialektin gegë, gjegjësisht në variantet e tij. Folësit e këtij varianti të shqipes, në aspektin historik, kanë sjellë ndryshime gjatë shqiptimit sidomos në sistemin tingullor.

Në këtë punim do të trajtojmë veçoritë fonetike dhe morfologjike në të folmen e Miratocit. Ky vendbanim shtrihet në jug të Preshevës dhe gjeografikisht ka afërsi me katundet Llojan, Vaksincë, Orizare. E kemi përzgjedhur atë si objekt studimi dialektor për disa arsye:

Katundi ka një histori vendbanimi;

Shquhet për veçantitë e një të folmeje gege me disa specifika që nuk hasen në katundet e tjera të Preshevës; Ka hundorësinë;

Ka përngjasime me të folmet e disa fshatrave të Kumanovës, gjegjësisht të Likovës.

Hulumtimi është bazuar kryesisht në përshkrimin fonetik dhe janë incizuar disa informatorë, që na kanë ndihmuar mjaftueshëm për t'i nxjerrë karakteristikat e kërkuara.

Fjalët kyçe: pozita gjeografike, sistemi fonetik, sistemi morfologjik.

Hyrje

Miratoci është fshat në kufi me Maqedoninë, 6 kilometra në jug të Preshevës me shtrirje midis 460 dhe 510 m të lartësisë mbidetare. Ai shtrihet në shpatet lindore të Karadakut (masivi serpentini i Llojani), ndërsa ngastra e fshatit kap edhe pjesën burimore të lumit Banjka. Fshati ka 2986 banorë (sipas regjistrimit të 2002) dhe 30% e popullsisë ndodhen me punë të përkohshme në botën e jashtme. Fshati ka 12 mëhallë (lagje): *kajosh, punar, fezllar, has, xhelep, xhuxh, xhagadur, malok, vack, qos* dhe *karxh*. Predispozitat natyrore kanë kushtëzuar që fshati historikisht të mbajë lidhje dhe kontakte më intensive me fshatrat shqiptare të rrethit të Kumanovës dhe Likovës, ndërsa fshatrat Llojan, Vaksincë e Sllupçan kanë bërë pjesë në arealin e ngushtë dhe të gjerë gravitues që kishin si qendër Miratocin. Rreth 700 ekonomi familjare merren me bujqësi ekstensive, ndërsa paratë e sjella nga bota e jashtme, sikur në vendbanimet tjera shqiptare, janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për popullsinë. Ajo (popullsia) merret me kultivimin e perimeve, drithërave e më pak të duhanit e pemëve. Një nga problemet kryesore me të cilat po ballafaqohet popullsia e fshatit është mungesa e lëvizjes së lirë për shkak të pamundësisë së kalimit të kufirit shtetëror me Maqedoninë dhe rrugën lokale kah fshati Llojan. Ky izolim komunikativ po i kontribuon ndarjes fizike dhe shpirtërore të popullsisë shqiptare të Luginës së Preshevës me atë të Maqedonisë, duke ngushtuar gjithashtu hapësirat dhe mundësitë për zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë në përgjithësi në të dy anët e kufirit. Edhe pse shumë afër mes vete, banorët e këtyre fshatrave të cilët kanë lidhje të shumta

farefisnore duhet të bëjnë disa dhjetëra kilometra rrugë për ta vizituar njëri-tjetrin. Një pjesë e territorit të fshatit preket edhe nga traseja e Korridorit X, që duhet parë si avantazh për valorizimin shumëdimensional përmes ndërtimit të objekteve të ndryshme shërbyese, pikave transite të shitjes dedikuar pasagjerëve dhe turistëve transit, siç janë qendrat tregtare dhe pikat e karburantit të cilat mund të shndërrohen në veprimtari shumë fitimprurëse për pupullsinë e fshatit^{xi}. Fshati ka një historik dhe banorët e kësaj ane janë vendës e disa janë të ardhur prej viseve të ndryshme. Martesat mund të bëhen edhe brenda fshatit.

Kur jemi te e folmja e Miratocit të Preshevës, themi me plot gojë se ky rajon nuk ka qenë asnjëherë objekt studimi dialektor, ndaj edhe në këtë punim jemi përpjekur t'i paraqesim veçoritë fonetike dhe morfologjike të cilat janë me interes për dialektologjinë tonë shqiptare.

Folësit e këtij fshati kanë sjellë ndryshime gjatë shqiptimit sidomos në fushën e fonetikës ku dallimet vërehen nga fshatrat e tjerë të komunës së Preshevës. Ekspeditën tonë e kemi mbështetur tek brezi i vjetër dhe i mesëm e më pak i riu dhe subjektet nga e kam marrë materialin janë moshash të ndryshme. Prandaj, dua t'i falënderoj informatorët për durimin e tyre, gatishmërinë dhe mikpritjen që ma bënë gjatë punës sime hulumtuese.

Fonetika

Vështruar nga aspektin fonetik, kjo e folme ka një inventar të pasur zanoresh. Ka këta tinguj zanore të theksuar: **a, i, u, o, y**. Nga aspekti funksional (nga pikëpamja e kundërvënies fonologjike), e folmja e Miratocit në sistemin e saj vokalik ka 23 vokale të theksuara: /ǎ/, /ā/, /ã/, /ā□/, /ē/, /ē/, /ɛ/, /è/, /ē□/, /ī/, /ī/, /ĩ/, /ĩ□/, /ō/, /ō/, /ū/, /ū/, /ū□/, /y/, /ỹ/, /y□/, /ỹ□/.

Zanoret dalin të gjata, të mesme dhe të shkurtra. Të gjatat dalin në rrokje të hapur dhe të mbyllur: *fukarā, dŷnjā, ñū, shpī, hāp, kāp, shkūl, mōll, gūr* etj. Për shkak të rënies së një tingulli apo të ndonjë rrokjeje në fjalë me anë të proceseve fonetike të aferezës, sinkopës e apokopës, fjalët shumëërrokëshe shkurtohen dhe bëhen njëërrokëshe, pra kemi: *Mūs* (Musli, Musah), *Sŷl* (Sylejman), *kūsh* (kushëri). Zanorja është e gjatë edhe në ato raste kur shoqërohet nga një bashkëtingëllore hundore, ku kemi edhe rënien e zanores së patheksuar ë: *brŷ□m, frŷ□m, hā□n*. Zanoret e gjata ashtu si edhe në disa të folme të tjera të gegërishtes përbëjnë një seri fonemash duke krijuar kundërvënie fonologjike për diferencime morfologjike. P.sh.: *vesh* (organ i të folurit) - *veshi* (për të veshur); *thīk* (teposhtë)- *thīkë* (mjet për prerje); *pres* (pres dikë)- *prejta* (pres bukën).

Të mesme janë atëherë kur të shkurtrat gjatë fleksionit kthehen në të mesme: *spēc-speci, dāsh-dashi*. Do thënë se në këtë të folme vokalin “e” e ndeshim zi zanore të mesme të hapur, ndryshe nga fshatrat e tjerë. P.sh.: *vēsh* (për të veshur) - *vesh*; *spec-spec*; *sjell-sell*. Zanoret e shkurtra i gjejmë në rrokje të mbyllur: *mīk, plāk, sakāk, kōs, mīsh* etj.

Hundorësia

Shqiptimi nazal i një zanoreje ndodh kur zëri kalon në zgavrën e gojës po çilet palati (qiellza) diçka kështu që ajo kalon nëpër zgavrën e hundës^{xi}. Në këtë të folme nazalizimi i vokaleve të ndodhura para bashkëtingëlloreve hundore i ka përfshirë të gjitha zanoret (përveç o-në) sidomos **a**-në dhe **u**-në dhe në pozicion para konsonanteve nazale, zanorja është e tillë te këto fjalë: *bāj, rrāj, nā□n, dhāndërr, xhā□, mullī□, hū□-ni, drū□-ni, sŷ□ni, tlŷ□ni, sā□n, hā□n, dry□ni, xhilpā□n, njā*, etj. Zanore hundore gjejmë edhe tek rastet kur kemi dhe jo reduktim të grupeve të bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng**. P.sh.: *shkū□m, kā□m* (këmbe), *hā□ngra, ngū□tna, ngū□l*. Hundorësinë e ndeshëm edhe në fjalët kur nuk kishte zanore hundore, ndaj kemi regjistruar këto fjalë: *khā□, çitā□, marā*. Sipas Gjovalin Shkurtajt^{xi} ka raste që zanorja nuk merr nuancë hundore edhe nëse është para hundoreve. Nazalizimi i vokaleve shërben edhe për dallim kuptimi të disa fjalëve: *āsht-është; āsht-kockë; vrā□nt* (është vrenjtur qielli)- *vrā□* (për të vrarë), *brī□* (brinja e trupit)- *brī□* (përballë). Hundorësia në këtë rajon na del edhe para bashkëtingëlloreve hundore: *sŷ□, prrū□, shē□j*. Zanoret hundore i ndeshim në rrokje të hapur: *pē□, hū□, gū□, trū□*. Nga materiali i nxjerrë në terren vërejmë se vokalet hundore mund të jenë të gjata, të mesme (zanore hundore të hapura).

Një veçori e kësaj të folmeje ashtu sikur në të folmen e Postribës^{xi} është zanorja “a” e cila në pozicion parafundor e fundor (qoftë e gjatë apo e shkurtër) dëgjohet nganjëherë edhe si “o” gojore, pra e labializuar, si: *pāre-pōre, e mādhe- e mōdhe nāt-nōt, gjermān-gjermōn, shejtān-shejtōn*. Por, ndodh e kundërta, pra kemi: *konop-kanap, konak-kanak*. Foljet ndihmëse KAM dhe JAM nuk na dalin me nuanca hundore edhe pse zanorja “a” ndodhet para konsonantes **m**. Pra, vetëm në këtë fshat këto dy folje në kohën e tashme të vetës së parë na dalin sipas gjuhës letrare.

Zanorja “a” orale e shkurtër dëgjohet edhe si “ε” e hapur: *skaj-skej, përskej-përskej*. Vokali “o” kur ndodhet para **n**-së mund të ndërrohet në **ā** hundore. P.sh.: *sōnte-sā□nte, llōm-llām, thōm-thām, limōn-limān* (edhe emri *Limān*). Ky fenomen ka një kushtëzim fonetik që lidhet me mungesën e hundorësisë së zanores “o” të theksuar e që haset edhe në të folmen e Gollakut^{xi}.

Ë-ja bie në pozicion fundor: *cūll, dēr, zōrr*; në mes të fjalës: *shōkt*. Ndërkaq, ruhet në ato raste kur ndiqet nga **l, ll**: *gōgël, vëgël, i egër* etj. **Y**-ja nuk del e alternuar në i asnjëherë siç ndeshet në fshatrat kufitare Llojan, Vaksincë, Sllupçan. Pra, këtu ndeshim: *qylym, bylmet, sŷ□*.

Diftongjet

Diftongjet ashtu si në tërë rajonin e Preshevës, edhe këtu, dalin të monoftonguara. Diftongu “**ue**” në pozicion fundor në rrokje të hapur është monoftonguar: *grū, çū, blū, kallxū*. Grupi “**ye**” e ka të theksuar vetëm labialen “**y**” dhe kemi: *dŷr, fyll, karcyll* etj.

Diftongu “**ie, je**”. Përderisa në fshatrat e tjerë të Preshevës dhe në qytet është monoftonguar në “**i**” si te fjalët *mīll, çīll, dīll*, në vend të *miell, qiell, diell*, në të folmen e Miratocit,

ky diftong është shndërruar në një zanore “*ε*” të hapuar. Pra, dëgjojmë: *mell, sell, pell, vell, pepën-*vetëm brezi i vjetër, *mel, bere-* për bjere, *me ver* – për të vjerur etj.

Sistemi konsonantik na paraqitet pothuajse i njëjtë sikurse në fshatrat e tjerë përreth, kështu që nuk po ndalemi për shqyrtim të detajizuar.

Grupet e bashkëtingëlloreve

Grupi konsonantik mb. Në këtë të folme është reduktuar në bashkëtingëllore të thjeshtë hundore “*m*”: *mrêna, kâma, kûmlla, prā□m, pamûk*. **Grupi nd** ka dhënë në çdo pozicion vetëm bashkëtingëllore të thjeshtë sonante hundore: *nêr, faleminêr, vên, nû□, i rân, nû□k, ândërr*. **Grupi ng** është asimiluar në një tingull-fonemë bashkëtingëllore prapagjuhore hundore. P.sh.: *hāṇgra, i ṇgrāt, i ṇgusht, kâṇ, kûṇëll, lāṇ, zhāṇël* etj. **Grupi ngj** ka kaluar në “*nxh*”: *nxhūt, kīnxh, me nxhÿ*. Grupi **fsh** mbetet i pandryshuar, si: *fshāt, rrāfsh, kōfsh, kōfsh, i fshīm*. Grupet **tj** dhe **dj** janë evoluar në bashkëtingëllore palatale **q, gj**: *qetër, qera, gjepi, me gjeg* etj.

Fenomenet fonetike

Metafonia ndeshet në sistemin emëror dhe foljor *dāsh-dësh, plāk-plëç, dal-del, marr-mer*. **Apofonia**- diftongu **ie/je** ashtu siç është përmendur më lart është alternuar në *ε* të hapur të mesme dhe kemi: *mella, gjega, peka*. P.sh.: *a i peke būkt*. Nga brezi i vjetër e më pak i mesmi dëgjojmë, si b.f. *u pek pepni*, kurse nga brezi i ri ndeshim *u pjek pjepni*. **Metateza** është proces fonetik kur dy tinguj të një fjalë i këmbëjnë vendet reciprokisht. Në këtë të folme me metatezë na dalin këto fjalë: *pshtëj-shpëtoj, hamāk-ahmak, shafōn-fashit, dārsēm-dasmë, xhÿ□ms-gjysmë, shlōj-lëshoj*. **Asimilimi** ka përfshirë zanoret: *qeremītk-qeramidhe, yshym-ushqim, katolik-katalik, limān-limon, marāk-merak, i vjem- i vjëm; asimilimi i bashkëtingëlloreve: *i lākt-i lagët, z’bān-s’bën* etj.*

Shtesat e tingujve

Proteza nënkupton shtimin e tingullit apo të një grupi tingujsh në fillim të fjalës, ndaj këtu ndeshim: *çaty□, çeshtë*. **Epenteza**- shtimi i tingullit në mes të fjalës: *shpīja, xhamīja, e reja, shājta, prejta, kceva, nōva, dhevi, shkāvi, i revī(i riu)*. **Epiteza** – nuk e kemi hasur.

Rëniet e tingujve

Afereza është rënia e tingullit apo e një grupi tingujsh në fillim të fjalës. Këtë dukuri e kemi ndeshur tek folja *vdes*, p.sh.: *ka dek*. Më së shumti haset tek emrat e përveçëm: *Tāf-Mustafë, Xān-Murtezan*. **Sinkopa** – rënia e tingullit në mes: *msōj-mësoj, gzōj-gëzoj, vetëll-vetulla, petëll-petulla*. **Apokopa** – rënia e tingullit në fund: *kūsh-kushëri, erdh-erdhi, përkū□n-përkund*. **Elizioni** është zhdukja e vokalit fundor të patheksuar përpara vokalit nistor^{xi}. Në Miratoc është mjaft i përhapur dhe e ndeshim në këto fjali: *nūsja re u kâ□n gje, ūji Vrellës, āra Fëjzës* etj.

Veçoritë morfologjike

Në këtë të folme kemi dy gjini emrash: mashkullore dhe femërore. Emrat e gjinisë asnjëanëse janë integruar në mashkullore dhe femërore, ndërkaq emri “*kryet*” ka marrë gjininë femërore, pra kemi “*krÿja*”. Emrat e gjinisë mashkullore që dalin me bashkëtingëlloret *k, g, h*, në trajtën e shquar marrin mbaresën **i**: *sakaki, miki, ūki, zogi, krahi, ahi*. Po ashtu edhe emrat me zanore të theksuara *a, e, i*, dalin me mbaresën **i**: *kāvi, dhevi, thīvi*. Këtu hyjnë edhe emrat që mbarojnë me zanore hundore të shquar: *pê-ni, sy□-ni, mullī-ni, drū-ni*. Kujtojmë se nyjën e prapme **i** në vend të **u**-së në të shquarën e ndeshim edhe në të folmen e Kumanovës^{xi}, të Lurës^{xi}, të Opojës^{xi}. Emrat *deti, kali, guri, bari, shati* përdoren vetëm në trajtën e shquar. Ndërsa në të folmen e fshatrave të Lugut të Drinit të Bardhë dalin edhe në të pashquarën, si: *gūr, kāl, bār, shāt^{xi}*. Togun **ue** emrat në të shquarën e kthejnë në **o** dhe në fund marrin **o**: *ftōni, thōni, prrōni*. Emrat të cilët në trajtën e pashquar dalin me **ull** dhe **ur** në këtë të folme na dalin me **ëll**, përkatësisht **ër**: *vetëll, ūfëll, lepër*. Shumësi i emrave mashkullorë del me forma të ndryshme. Ata emra që në gjuhën letrare dalin me temë në zanore të patheksuar **ë**, në këtë të folme dalin me **a**: *traktōra, shofëra, drejtōra, generālla, nxānsa* etj. Ndeshim edhe shumësin e disa ermave me bashkëtingëlloret **ll-j**. P.sh.: *kūñëll-kūñgi*, por edhe *kūñga*. Pra, në këtë të folme shumësi del me **i** e jo me **j**. Plurali i emrit *knus* ka trajtën *knū□sët-knūst, knojst*, kurse në Kumanovë bën *knusa-knausa*, por edhe *knos^{xi}*.

Femërorët. Të gjinisë femërore janë emrat që dalin me temë në bashkëtingëllore sepse në fund ka rënë zanorja **ë**: *dōrdh-dārdh, dōr, pūl, mōll, peshk* etj. Femërorë janë edhe emrat njërrokësh e shumërokësh me **ε** të hapur të mesme (karakteristike për këtë të folme): *fe-feja, re-reja, del-j-a, nū□s-j-a, pōr-j-a (paraja)* etj. Ambigjenë dalin emrat: *mal-male-malna, livadh-livadhe*. Në numrin shumësi disa emra femërorë marrin mbaresën **a**: *dōrdh-dōrdha, ār-āra, thā□n-thā□na, therr-therra*. Një numër emrash në të folmen e Preshevës përgjithësisht dalin në shumësi me **t**, ku sipas prof. Rexhep Ismajlit^{xi}, këta më herët kanë qenë asnjëanës, pra kemi: *lūg-lūgt, būkt, zōrrt*. Ndaj, edhe në të folmen në fjalë i gjejmë edhe sot e kësaj dite.

Gjinia asnjëanëse. Neutri është zhdukur plotësisht dhe tani emrat e kësaj gjinie kanë kaluar në mashkullore dhe femërore: *tly□ni, vjōmi-vjāmi, mjōlti-mjālti, gjōthi-gjāthi, brūmi*. Emri **krye** ka kaluar në femërore **krÿ□ja**. Kurse në Kumanovën fqinje, **y**-ja është alternuar në **i**: *krie-ja, ja kērsita krēs^{xi}*. Në Miratoc dëgjojmë fjalinë: *ja rrōsa, mshōva nkrÿ□je*. Në këtë të folme ndeshim edhe emra përmbledhës, si: *granimi, burrnimi*. Trajta dhe forma e emrit *voxhlimi* që e ndeshim në fshatrat e tjerë, por edhe në qytet, në Miratoc na del me formën *cūllt*. P.sh.: *cūllt i kemi mōr me veti, ky kana cūll halo* etj.

Sistemi rasor është pothuajse në përputhje me gjuhën letrare. Por, në rasën rrjedhore është reduktuar mbaresa **sh** e cila është zëvendësuar me **ve**. Atë e hasim në këta shembuj: *I ven dōrësh, e mur msÿsh (msīsh në rajonin e Kumanovës)*. Po japim më poshtë lakimin e emrit “**dhe-u**” nëpër rasa:

E. dhevi
gj. i,e dhevit
dh. dhevit
k. dhevin
rr. pi dhevit

Në emërore kemi mbaresën **i**, ndërkaq në gjinore, dhanore e rrjedhore **it**, në kallëzore **in** dhe tingullin antihiatizues **v**.

Mbiemrat

Mbiemrat në të folmen e Preshevës, por edhe në atë të Miratocit, na dalin me prapashtesat **ëm** dhe **t**, mbiemra që në gjuhën e sotme letrare marrin **ur**. P.sh.: *i pasëm, i gjekt/i gjegëm, i shtremt, i dukt, i ndreçt/i ndreçëm, i dalëm, i pekt/i pekëm/i pjekt/i pjekëm* etj. Ndërkaq, me sufiksin **shëm** ndeshen këta mbiemra: *i xhëndshëm, i njāfshëm, i sellshëm*. Mbiemrat femërorë marrin mbaresën **e**: *e pasme, e dalme, e pekme/e pjekme, e xhëndshme, e njāfshme, e sellshme* etj. Adjektivi *i vōgël/i vāgël* në plural përdoret me trajtën *t vāgël/t vāxhli*.

Numërorët

Numërori **një** në të folmen e Miratocit ka trajtat *nī/njā*, ku në fshatrat e tjerë çdoherë ndeshim *njō*. Numërori *nī* mund të përdoret para një emri. P.sh.: *nī çik e kam pōs; veç nī megje na ndān* etj. Ndërsa, numërori *njā* mund të qëndrojë i vetëm dhe jo në bashkëvajtje me ndonjë emër: *njā ja kam dhā□n; njā u kān ktu e njā agje*. Nga ky numëror dalin rrjedhojat e tij, gjegjësisht përemrat e pacaktuar: *njāni, asnjāni, dynjāni*.

Përemrat

Përemrat nëpër dialektet e shqipes hasen me forma të ndryshme. Në të folmen në fjalë ndesim përemrat vetorë, vetvetorë, dëftorë, pronorë, pyetës e të pacaktuar.

Përemrat vetorë

Përemri vetor i vetës së parë **unë** përdoret me tri trajta: *un, una, une*. Trajtën *una* e përdor vetëm brezi i vjetër. Paradigmën e këtij përemri dhe të tjerëve po e japim më poshtë:

E. un, una, une	ty	aj	ajo	na	ju	ata	ato
gj. - - -	-	atīna	asājna	-	-	atīnve	atīnve
dh. mu/muje	tī/tīje	atīna	asājna	neve	juve	atīnve	atīnve
k. mu/um	tī t	ato	ato	neve na	juve	ata	ato
rr. pi mu/ pi muje	pi tī/je	atij	asaj	pi neve	pi juve	pi atīnve	pi atīnve

Përemrat dëftorë

Dëftorët në këtë të folme ashtu si edhe në të folmet e tjera geqe, marrin parashtesën **ç/e**: *çaj, çajo, çeky, çekjo, çekto, çekta, çitã*. P.sh.: *çaj çaqe është çu po rrin hūnxh...* Përdorim anë edhe dëftorët: *çeçaj, çeçajo, çeçeto, çeçeki, çeçekjo, çeçekta, çeçekto*. Pronomët *ky, kjo, ai, ajo* në numrin njëjës në gjinore, dhanore e kallëzore marrin **na**. Tani po japim lakimin e disa përemrave dëftorë

E. ky	kjo	ktã	kto
gj. i, e kti(j)na	i, e ksaj(na)	i, e ktÿnve	i, e ktÿnve
dh. kti(j)na	ksaj(na)	ktÿnve	ktÿnve
k. ktã(n)	kto(n)	ktã	kto
rr. pi kti(j)na	pi ksaj(na)	pi ktÿnve	pi ktÿnve

Përemrat dëftorë *i, e atillë, i, e këtillë, të këtillë, të atillë*, na dalin me trajtat dhe format *asi, aso, çasi, çaso*. P.sh.: *çasi gjãthi hala s kam hãngër*. Përemra të tillë na dalin edhe në të folmen e Opojës^{xi}. Në të folmen e Kumanovës me rrethinë, përemrat *këta, këto*, marrin **ne** në shumës: *ju ka dal zani majr ktajnexi*. Kurse, këtu në mes të përemrit hyn edhe **v**-ja epentetike dhe kemi fjalinë: *ju ka dël zãni mÿr kty□nve*.

Përemrat pronorë

Përdorim mjaft të dendur kanë edhe përemrat pronorë, të cilët i gjejmë në të gjitha situatat e ligjëritimit të përditshëm. Dendur përdoren përemrat *jem, jeme, jôn, jot, jÿv, tãnd/e, tãnt, t juvt, t mit*. P.sh.: *gjãli jem punôn gjeth dÿtën, shkõlla jôn kã pak nxãnsa...* Më poshtë po japim lakimin e përemrave pronorë *jem, jeme* në bashkëvjatje me ndonjë emër

E. gjãli jem	çika jeme
gj. i, e gjãlit tem	i, e çikës teme
dh. gjãlit tem	çikës teme
k. gjãlin tem	çikën teme
rr. pi gjãlit tem	pi çikës teme

Pronori vetvetor **i vet, e vet - e vetja** ka një përdorim të dendur sin ë kuptimin e parë po ashtu edhe në ate në funksion të pronorit. P.sh.: *shpÿja vet, ky ã i veti, është e vetja, ãrët e veta, t veta*

Përemrat pyetës

Interes dialektor paraqet përemri pyetës kush, i cili në kallëzore na del më ndryshe nga fshatrat e tjerë të Preshevës. Paradigma e këtij përemri duket kështu:

E. kush
gj. i, e kujna/kuna
dh. kujna/kuna
k. kon/kãn
rr. pi kujna/kuna

Përemrat e pacaktuar

Përdorim kanë përemrat e pakufijshëm: *kurkush, asnjë, njëni, qetri, dā/dō, çeshit-çeshit*, etj.

Folja

Në këtë idiom dialektor, sistemi foljor ka disa veçanti gjuhësore nga të folmet e tjera përreth. Në përgjithësi kemi vërejtur këto fenomene, të cilat janë me interes dialektor:

Koha e tashme e mënyrës dëftore

Foljet e grupit të parë marrin mbaresën i e disa dalin edhe pa mbaresë. P.sh.: *eci, līdhi, dal*. Foljet e zgjedhimit të dytë **s:t** në vetën e parë të kësaj kohe marrin mbaresën i, por nga brezi i ri përdoren edhe pa mbaresë, si p.sh.: *kpūti, lūti, prīti*. Ndërkaq, foljet e zgjedhimit të tretë nuk kanë ndonjë ndryshim me të folmet e fshatrave të tjerë. P.sh.: *pūnoj, punōn, punōn, punōjm(i), punōni, punōjn, knōj, knōn, knōn, knōjm(i), knōni, knōjn, ngōj, ngōn, ngōn, ngōjm(i), ngōni, ngōjn, shkōj, shkōn, shkōn, shkōjm(i), shkōni, shkōjn* etj. Foljet ndihmëse KAM dhe JAM marrin këto trajta vetore: *kam, kē/kīje, kā, kemi, keni, kǎn; jam, jē, āsht, jemi, jeni, jān*.

Veçori e së folmes së Miratocit, ashtu siç e kemi thënë më lart, është se diftongu *ie/je* tek foljet si b.f. *mbjell, sjell, pjell, mjel* ndeshet pothuajse çdoherë i rrudhur, pra kemi: *mell, sell*, etj. Këtë dukuri e kishte vërejtur edhe prof. Rexhep Ismajli gjatë studimit të tij që e kishte bërë për të folmen e Preshevës^{xi}.

Koha e pakryer

Në këtë të folme, imperfekti merr mbaresat *sha/shna, (j)she, ke, shmi, shni, shin*. Ndeshen një numër i konsiderueshëm foljesh, si p.sh.: *laj, lëshoj, shkoj, msoj, lyp, harroj, hap, besoj, kontrolloj* etj. Gjatë hulumtimit nëpër terren regjistrua këto fjali: *punōjshna teri dymdhet n fūsh, masanēna i lishojsha xhā□ja me kullōt, harrōjshmi me ōrdh/ārdh n shpī, lypshin shum pi neve a na s kishmi kurxhā n dōr, z besōjke asnjā, s kishke arallēk, bājke vakī ka(h) dy jāv s vishmi, cūllt s po ngōjn*. Kurse e pakryera joveprore merr përpara pjesëzën **u**: *u la(j)shmi n Bllāt, u bājsha virān, u dērmōshin tu punū* etj.

Aoristi (Koha e kryer e thjeshtë)

Forma e aoristit në këtë idiomë është një karakteristikë që zgjon interes dialektor. Do thënë se foljet e tipit si b.f. *laj, shaj, ndaj* etj., dalin me temë të zgjeruar, pra kemi: *lājta, shājta, ndājta*. Koha e kryer e thjeshtë e foljeve me diftong në temë të kohës së tashme ka dy forma përdorimi. Në të folmen në fjalë, brezi i vjetër e përdor, pra, trajtën me diftong të rrudhur, ndaj kemi: *vedh-vōdha, sell-sōlla, mel-mōla, pek-pōqa, mell-mōlla*, kurse nga brezi i mesëm dhe i ri nganjëherë kemi prirje të rrafshimit të trajtave duke u nisur nga prezenti: *vjedh-vjōdha vjedha, sjell-sjōlla-sjella*. Më herët nga brezi i vjetër dhe i mesëm është dëgjuar fjalia: *u pek pepni*, kurse sot mund të dëgjojmë edhe *u pjek pjepni*. Mund të themi me plot gojën se ky diftong është në të gjitha brezat i rrudhur dhe rrallëherë e ndeshim të plotë.

Futuri formohet me foljen ndihmëse KAM +paskajore. P.sh.: *kam me òrdh, kam me punū te āra, kam me thā□n.*

Koha e kryer (Perfekti)

Kohët e përbëra përdoren mjaft dendur. E **kryera** ashtu si në të folmet e tjera geqe formohet me foljet ndihmëse *kamdhe jam*: *kam shkū me gjālin, ka pās shum cūll me veti, kena dāl/dōl n māl, kemi shkū n kām n Llajān*, kurse forma pësore: *jam lā me shōk gjeth dītēn n Bllāt, jeni kām t marēm vesh*, etj. Folja *kam*: *kam pās, ke pās, ka pās, kemi pās, keni pās, kan pās* (pjesorja e kësaj foljeje del edhe me trajtēn *pōs*, pra *kam pōs*). Folja *jam*: *jam kām, je kām, ā/āsht kām, jemi kām, jeni kām, jan kām*. Në të folmen e Preshevës është e përhapur edhe një lloj forme e pësore-vetvetores së kryer i ndërtuar me grimcēn **u** dhe me trajtēn e ngurosur të së kryerës aktiv: *mu ka gjēg, m u ka vrā, mu ka līg^{xi}*. Në Kumanovë haset forma *u ka zaiftu, na u kish bo^{xi}*.

Më se e kryera formohet gjithashtu me anë të foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam*. P.sh.: *kish(na) punū, ish(na) shētīt* etj. E **tejskhuara** e veprorës formohet nga folja *kam*, si p.sh.: *pat(na) lā*, ndërsa joveprorja duke ia paravënë foljes pjesëzēn **u**, pra kemi: *u pat(na) lā*.

Lidhorja

Ashtu si edhe në disa të folme të tjera, edhe këtu lidhorja është zëvendësohet me paskajoren. Foljet në vetën e dytë njëjës marrin mbaresēn **sh** (me temē zanore). P.sh.: *le t vīj le t vīsh, le t vene, le t vem, le t vini, le t vī□n*. Folja *jam*: *t jam, t jesh, t jet (t āsht), t ishmi, t ishni, t ishin*; folja *kam*: *t kam, t kish, t kā, t kemi, t keni, t kan*. Forma e pasivit indikativ merr mbaresēn **na** në vetën e parë njëjës: *bāhna, bāhēsh, bāhēt, bāmi, bāni, bāhēn*.

Habitorja paraqet një veçori të kësaj të folmeje sidomos prezenti dhe kohët e së shkuarës. Me interes janë format e foljeve ndihmëse *kam*: *pana, pahe, paha, pa(h)mi, pa(h)ni, pa(h)ēn* dhe *jam*: *kāne, kāna, kāna, kānkmi, kānkni, kām(k)ē*

E pakryera

Në imperfekt të habitores ndeshet vetēm foljet *jam*: *kānksha, kānkshe, kānke, kānkshmi, kānkshni, kānkshin*. E **kryera** dhe **më se e kryera** formohet duke ia paravënë foljeve pjesore foljet ndihmëse në të tashmen, përkatësisht në të pakryerēn, pra kemi perfektin: *kāna kām i mōdh, e pa(h)ni shitū n kām gjātht* dhe pluskvamparfektin: *kānkshe bā□ si i xhetēm* etj.

Kushtorja

Përdorim kanë lloje të kushtores: **kam+paskajore ose me+pjesore**: *kishna me punū se kish(na) ārdh/ōrdh, me kām gjāl i mīr kishe shkū n shkōll* dhe parafjala **me+kam+pjesore**: *me pās kām kōha e mīr n kām ecshmi* etj.

Dëshirorja

E tashmja ndeshet më shumë se e kryera. P.sh.: folja *jap*: *dhāfsha/dhōfsha, dhāfsh/dhōfsh, dhāft/dhōft, dhāfshmi/dhōfshmi, dhāfshni/dhōfshni, dhāfshin/dhōfshin*. Folja *kam*: *pāça, pāç, pāst, pāçim, pāçi, pāçin*; folja *jam*: *kōfsha, kōfsh, kōft, kōfshmi, kōfsni*,

kōfshin. Trajtat e tyre ndeshën edhe në fshatrat e tjerë të Preshevës, kështu që nuk ka ndonjë dallim fonetik.

Urdhërorja ka vetat e dyta të numrit njëjës dhe shumës. P.sh.: foljet *bie:sjell*: *berma/bĩma*, *berni/bĩni*, *jepma/jĩpni*, *shlōma/shlōni* etj.

Format e pashtjelluara të foljes

Pjesorja del herë e reduktuar e herë e zgjeruar. P.sh.: *lā□n*; *kam lā/ kam lājtēn*; *çā-çāj-t-çāj-tēn*; *xhtēt-xhētēn*; *līdh-līdhēn*; *zā□-zā□n* Nuk e kemi hasur të zgjeruar pjesoren e foljes *běj*, si p.sh.: *e kishni bā□*. **Paskajoren** e ndeshim të njëjtë sikur në të folmet e tjera të gegërishtes, e cila formohet nga parafjala **me+pjesore**: *me shkūl(ēn)*, *me sell*, *me dredh*, *me pēk/me pjek*, *me dēk* etj. Përdorim ka edhe forma e pashtjelluar mohore **pa+pjesore**: *pa thā□n(ēn)*, *pa mell s kā kurxhā*, *pa u lōdh z bān* etj. Gjithashtu në situata të shpeshta e hasim edhe formën e pashtjelluar **për+me+pjesore**: *për me pās duhēt me punū*, etj. **Përcjellorja** formohet me anë të pjesëzës **tu+pjesore**: *tu kesh/tu kēsh*, *jam tu shkū n Preshev*. Në këtë të folme (nga të gjithë brezat) përdoret edhe koha e kryer e mbipërbër. P.sh.: *paha pās punū*, *kāna pās kān*.

Ndajfoljet. Vlen të përmenden këto lloje ndajfoljesh: *khā*, *knej*, *knēna*, *sā□nte*, *nesra*, *shtĩ*, *agje* etj.

Përfundime

E folmja e Miratocit të Preshevës ngërthen ato dukuri që përkojnë me të folmet e tjera, por ka edhe disa veçanti. Pozita gjeografike e saj ka bërë që të ketë bashkëpërkime fonetike dhe morfologjike me të folmet e fshatrave të Kumanovës (tashmë të Likovës) dhe të dallohet për disa tipare nga e folmja me Preshevës përgjithësisht.

Disa karakteristika të saj janë: nazalizimi i zanoreve është mjaft i pranishëm, gjë që nuk e hasim në fshatrat e tjerë, përveç në Karadak me paraqitje të zbehur. Koha e tashme e dëftores e foljeve me “ie”, si: *vjedh*, *sjell*, *mbjell* etj., na del e rrudhosur. Foljet ndihmëse KAM dhe JAM në vetën e parë njëjës të së tashmes veprorë dalin sipas gjuhës letrare dhe në kohën e tashme, të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën e habitores ndeshen me trajta të ndryshme, të cilat përkojnë me të folmen e Kumanovës me rrethinë etj. Nga analiza jonë gjuhësore dhe përshkrimi në terren, të cilat përkojnë me shtrirjen gjeografike mund të përfundojmë se kjo e folme i përket gegërishtes verilindore, por në të gjejmë edhe tipare të gegërishtes qendrore. Pra, është një izoglosë ndërkaluese ndërmjet të dy nëndialekteve të gegërishtes.

Bibliografia

- Çabej, Eqrem (1970). *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe-Fonetika historike e gjuhës shqipe*. Prishtinë.
- Haxhihasani, Qemal (1963). *Vëzhgime gjuhësore në krahinën e Lurës*. BUSHT. SSHSH 4 viti XVII. Tiranë.
- Ismajli, Rexhep (1971). *Vërejtje mbi të folmen e Preshevës-Morfologji*. Dituria 1. Prishtinë.
- Islami, Hevzi - Ejupi, Arsim (2015). *Popullsia dhe vendbanimet shqiptare të Luginës së Preshevës*. ASHAK. SSHSH. Prishtinë.
- Luli, Frano (1974). *E folmja e Postrribës*. Studime filologjike 3. Tiranë.
- Munishi, Zijadin (1980). *Veçoritë fonetike dhe sistemi i zanoreve në të folmen e Gollakut*. GJA. SSHF IX. Prishtinë.
- Pajaziti, Naser (2005). *E folmja e Opojës*. Prishtinë.
- Shkurtaj, Gjovalin (1967). *E folmja e Kastratit*. SF nr.2. Tiranë.
- Ymeri, Haki (1982). *Veçoritë morfologjike të së folmes së Kumanovës me rrethinë*. Jehona 1-2. Shkup.
- Zyberi, Abdullah (1971/1972). *Vëzhgime mbi të folmen e fshatrave të Lugut të Drinit të Bardhë*. Dituria 2-3. Prishtinë.
- Zyberi, Abdullah (1976). *Vëzhgime mbi të folmen e Opojës-Morfologji e leksik*. SSHF V-1975. Prishtinë.